



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
Kryesia

Nr. 345 prot

Tiranë, 08.3.2024

Vendim, nr. 30 datë 08.3.2024

**Për miratimin e projekteve shkencore në kuadër të thirrjes së
PKKZH 2024-2025, të AKKSHI**

Në mbështetje të nenit 4, (pikat 2 dhe 9) të Ligjit nr. 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë* (i ndryshuar);

Në pajtim me nenin 4 dhe 57 të Statutit të Akademisë së Shkencave (i ndryshuar);

Mbështetur në thirrjen për aplikim të Projekteve Kombëtare për Kërkim e Zhvillim (PKKZH) 2024-2025 të AKKSHI-së;

Kryesia e Akademisë së Shkencave, pasi shqyrtoi kërkesat për aplikim, të paraqitura nga njësitë kërkimore shkencore të ASHSH, pas miratimit të strukturave përkatëse dhe të paraqitura nga dy kryetarët e seksioneve (SSHNT, SSHSHA),

Vendosi:

1. Të miratojë vazhdimin e aplikimit pranë AKKSHI-së të projekteve:
 - *Fenomeni i lëngëzimit të trojeve dhe rëndësia e studimit të tij në planifikimin e zhvillimit urbanistik dhe infrastrukturor të zonave bregdetare - rast studimi Gjiri i Lalëzit, me drejtues shkencor prof. asoc. Shkëlqim Daja.*
 - *Gjuha vjen e para - Matja e aftësive në moshat e hershme: identifikimi dhe trajtimi i aftësive ligjërimore për zhvillimin e kompetencave kyçe të të*

nxënit, me drejtuese shkencore projekti prof. asoc. Enkelejda Kapia Bakallbashi.

- Qendra e dokumentacionit artistik, me drejtues shkencor projekti, akad. asoc. Stefan Çapaliku.

- Rruga dhe sfidat drejt një sistemi të integruar të energjisë në Shqipëri me 100 BRE (Burimet e Rinovueshme të Energjisë) dhe plotësisht të dekarbonizuar në vitin 2050, me drejtues shkencor projekti prof. asoc. Lorenc Malka.

- Krijimi i radhoit Elektronik te Toponomastikës së Shqipërisë (digjitalizimi i skedave të Toponomastikës ne Arkivin e IGJL-së), me drejtuese projekti dr. Enkelejda Shamku-Shkreli dhe prof. asoc. Merita Sauku-Bruci.

- Vlerësimi sasior dhe cilësor i burimeve natyrore ujore në zonat ndërkuftare të Shqipërisë me Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, me drejtues shkencor dr. Arben Pambuku.

- Ndikimi i acidit borik në parandalimin dhe trajtimin e osteonekrozave të nofullave të shkaktuara nga medikamentet, me drejtues shkencor prof. asoc. Erida Qorri.

- Mbi valorizimin e disa mbetjeve të ngurta të industrisë ushqimore dhe shfrytëzimin e tyre për përfitimin e bioenergjisë dhe produkteve specifike të dobishme, me drejtues shkencor akad. Ilirjan Malollari.

- Integrimi i faktorëve gjenetikë dhe mjedisorë për të nxitur prodhimtarinë dhe shëndetin në delet autoktone, me drejtues shkencor, akad. asoc. Anila Hoda.

- Hartografimi dhe dokumentimi i zonave me potencial arkeologjik të Lezhës (Lissus) me drejtues shkencor prof. Neritan Ceka.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: kancelari, drejtori i QKPKSH, sektori i finances dhe i buxhetit, kryetarët e seksioneve.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

